

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vakancat në Kushtetuese/ KED kualifikon Alban Toron, Arta Vorpsin dhe Genci Gjonçaj! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/vakancat-ne-kushtetuese-ked-kualifikon-alban-toron-arta-vorpsin-dhe-genci-gjoncaj/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 14:55:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 14:49:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cf0cd0c56577a1ab8c2c910ba06ea1facb5ac2cbba7299658a46c87dfb2e8287
TEKSTI	3e81b9b85963408da4dce60926c524b0c4c285226025c6dfc4378815ee67d9ad
PAMJA	27973fff91bbc41ca5a3f4385c31f79d01445f5a165b5067ebb7608ef4434aa6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dcd7d0ced789592f35e40e0a1d18f4b0ba36384134d7ebe519e7970a4866b987
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8e58cd7c2ba18fe8505fde5d6e6dfddc77f272b2048ef5da6967fe3daa743e71
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dcd7d0ced789592f35e40e0a1d18f4b0ba36384134d7ebe519e7970a4866b987>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet

Vakancat në Kushtetuese/ KED kualifikon Alban Toron, Arta Vorpsin dhe Genci Gjonçaj!



Ervin Nikolla

24 Shtator 2026



Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur të lejojë për të kandiduar për 2 vende vakante të **Gjykatës Kushtetuese** Alban Toron, Arta Vorpsin dhe Genci Gjonçaj ndërsa ka ndaluar kandidimin e Brunilda Bara.

Me vendimin e fundit të KED, tashmë bëhen 5 anëtarë që u është hapur rruga për në GJK, përfshirë edhe Jordan Dacin dhe Naureda Llagamin, që u lejuan disa ditë më parë. Më herët KED ndaloi kandidimin e ish-komisionerit të Komisionit të Kualifikimit (KPK), Lulzim Hamitajt.

Gjykata Kushtetuese aktualisht ka 2 vakanca të krijuara në shtator të 2024 pas dorëheqjes së gjyqtarës Elsa Toska dhe vakanca tjetër është krijuar pasi vetë Gjykata Kushtetuese konstatoi mbarimin e mandatit të gjyqtarës Sonila Bejta në tetor të vitit 2025.

Për vendin e Elsa Toskës janë në garë 9 kandidatura, ndërsa për vendin e Sonila Bejtës janë në garë 10 kandidatura. Zëvendësuesen e Elsa Toskës duhet ta emërojë Parlamenti, ndërsa të Sonila Bejtjas, Presidenti.

Për të zënë vakancën e Sonila Bejtës kandidatë kanë qenë:

Alaudin Malaj
Alban Toro
Alma Faskaj Vokopola
Arta Vorpsi
Brunilda Bara
Genci Gjonçaj
Jordan Daci
Lulzim Hamitaj
Naureda Llagami

Roland Ilia

Ndërsa për vakancen e Elsa Toskës kandidatë kanë qenë:

Lulzim Hamitaj
Genci Gjonçaj
Naureda Llagami
Fatmira Luli
Lulzim Karini
Roland Ilia
Helena Papa
Jordan Daci
Arta Vorpsi

Që prej shtatorit të vitit 2024, kur ish anëtarja Elsa Toska dha dorëheqje të menjëhershme, Kushtetuesja nuk e ka pasur të plotë trupën prej 9 anëtarësh, duke sjellë edhe vështirësi në marrjen e një vendimi të qartë.

Zëvendësimi i Elsa Toskës u zvarrit, pasi kohëzgjatja e mandatit të saj u vendos në pikëpyetje, nëse duhet të ishte i plotë, apo i pjesshëm. Kuvendi ndali procedurat, deri kur Gjykata Kushtetuese dha një vendim final dhe tregoi se edhe Elsa Toska, si Holta Zacaj dhe Sonila Bejtja nuk duhet të gëzonin mandat të plotë, por të pjesshëm, për të garantuar ripërtëritjen apo rifreskimin e pjesshëm të GJK, me 3 anëtarë për çdo tre vjet, sipas Kushtetutës. Më pas Komisioni i Ligjeve hapi edhe një herë aplikimet për të gjetur një gjyqtar kushtetues, i cili do të zëvendësonte Elsa Toskën.

Në fazën e fundit KED bën vlerësimin e kandidaturave sipas pikëve dhe renditjen ja dërgon Presidentit dhe Parlamentit. Si Presidenti dhe Parlamenti kanë të drejtë të zgjedhin një emër mes 3 kandidaturave të renditura të parat sipas vlerësimit me pikë të KED. Në Parlament nëse njëri prej 3 kandidatëve nuk merr numrin e duhur të votave (84 vota), kalon automatikisht ai që renditet i pari, sipas vlerësimit të KED.

Ky proces duhet të ishte mbyllur prej kohësh, pasi ka kaluar çdo afat i përcaktuar nga ligji, për zëvendësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese.

LAJME TË NGJASHME



Vakancat në Kushtetuese, KED i çon Gjykatës së Lartë listën me tre kandidatët, përzgjidhet vetëm një

1 MIN

MË TË LEXUARAT



U plagos pas konfliktit në Tiranë, një 49 vjeçar ndërroi jetë në spital!



Misteri i vdekjes së Maradonës merr kthesë të re, reagon eksperti dhe jep lajmin e hidhur!



GJKKO konfirmon masën e sigurisë për Vlora Hysenin!



4 suplemente që nuk duhet t'i merrni kurrë me ilaçet për tensionin e lartë!



"E kam nisur nga terreni, më pëlqen më shumë..." /Gazetarja Trevisa Tufa: Kur të jetë mundësia më e mirë në kohën e duhur...



Parkim me pagesë nga 5 tetori në Durrës, ja sa do të paguajnë qytetarët dhe çfarë përfitojnë rezidentët



Njihuni me ishullin ku derrat notojnë me turistët!



Ish-banorja e "BBV", Amber surprizon me transformimin e ri/FOTO!



Seriali kriminal që po çmend Netflix-in, 12.2 milionë shikime në vetëm katër ditë? Cili është?



De Rossi ende nuk i jep minuta në Serie A mbrojtësit të Kombëtares shqiptare Mario Mitaj!

EDITORI SUGJERON



3 ushqime që mund të ndikojnë negativisht te tensioni i gjakut!



Turmeric Latte apo Matcha Latte: cila ka më shumë përfitime kundër inflamacionit?!



Si ta kuptoni nëse një avokado nuk ia vlen të blihet?!



4 suplemente që nuk duhet t'i merrni kurrë me ilaçet për tensionin e lartë!



Çfarë është Waterpik dhe a do të mund ta zëvendësojë ai fillin dentar?!



Çaji apo kafeja?! Ja se cili është më i miri për shëndetin e kockave...



3 zakone fitnessi që duhet të filloni në moshën e mesme për një plakje të shëndetshme!



Mos e konsumoni kreatininë pluhur të thatë, një dietolog shpjegon mënyrën më të mirë për ta marrë!



Farat chia kundrejt farave të lirit, cilat kanë më shumë fibra dhe yndyra të shëndetshme?!



Lëng portokalli apo kafe: cili është më i mirë në mëngjes?!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.